



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 851/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.12.2018, shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Shfuqizimin e arsyes të skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “GPG Company” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt, “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Ndërtimi i linjave të shpërndarjes të qytetit Tepelenë*”, me nr. REF-81992-08-03-2018, me fond limit 92,263,883 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 11.09.2018, nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tepelenë sh.a.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertave të BOE “Shansi Invest” sh.p.k., & “Lala” sh.p.k. & “Biba X” sh.p.k. dhe BOE “Eral Construction Company” sh.p.k., & “Sterkaj” sh.p.k. & “Alb Shpresa” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar

Ankimues:

Operatori ekonomik “GPG Company” sh.p.k.
Adresa: Kodi postar 9001, Lushnje.

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjiellës Kanalizime Tepelenë sh.a.
Adresa: Bashkia Tepelenë, Kati II, Tepelenë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I


Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.



Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 06.08.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt “Ndërtimi i linjave të shpërndarjes të qytetit Tepelenë”, me nr. REF-81992-08-03-2018, me fond limit 92,263,883 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 11.09.2018, nga autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tepelenë sh.a.

II.2 Në datën 11.09.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nëpërmjet informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, konstatohet se në datën 24.09.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët me shumicë votash kanë vendosur si më poshtë vijon:

- | | |
|---|--------------------------------|
| 1. “Eral Construction Company” & “Sterkaj” & “Alb Shpresa” shpk | 85,505,686 lekë, Kualifikuar; |
| 2. “Shansi Invest” & “Lala” & “Biba X” shpk | 87,670,470 lekë, Kualifikuar; |
| 3. ”B-93” shpk | 90,700,111 lekë, Skualifikuar; |
| 4. “GPG Company” shpk | 91,814,942 lekë, Kualifikuar; |
| 5. ”Senka” shpk | 92,022,881 lekë, Skualifikuar; |
| 6. ”Uleza Ndertimi” shpk | 92,084,177 lekë, Skualifikuar; |

II.4.Në datën 26.09.2018 operatori ekonomik ankimues “GPG Company” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të KVO-së, si dhe kundërshton vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertave të paraqitura nga BOE “Shansi Invest” sh.p.k., & “Lala” sh.p.k. & “Biba X” sh.p.k. dhe BOE “Eral Construction Company” sh.p.k., & “Sterkaj” sh.p.k. & “Alb Shpresa” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]Ne lidhje me Kualifikimin e Operatoreve te tjere ku nga informacionet tona dyshojme per mosplotesimin e kriterëve teknike si:

1. Paraqitja e punimeve te ngjashme;

2. Stafit teknik / drejtuesve teknike te angazhuar/punonjes me kohe te plote ne administraten publike.

Gjithashtu edhe pse jemi kualifikuar, na eshte cituar qe nuk plotesojme kriterin e puneve te ngjashme. Ne si shoqeri, nepermjet sistemit elektronik te prokurimeve kemi paraqitur punime te ngjashme disa here me te medha nga kriteret ligjore dhe konkretisht:

b. Objekti “Ndertimi i HEC-it Borje Oreshke” Kukes, me vlere 858’454’617 leke nga ku kemi paraqitur te gjitha dokumentet e kerkuara ne DST. Objekti “Furnizimi me uje i fshatrave te komunes Golem” me vlere 420’309’288 leke, ku kemi paraqitur te gjitha dokumentet, pervec formularit te vleresmit. Mosparaqitja e Formularit te vleresimit per kete objekt eshte per shkak se Mbikeqyresi i punimeve dhe Atoriteti Kontraktor kane kerkuar Shtese Kontrate. Perderisa Kontrata baze eshte realizuar me 100% e faktuar nga dokumentet e paraqitura ku Autoriteti Kontraktor ka firmosur dhe vulosur situacionin perfundimtar dhe faturen e likuidimit e cila eshte derguar per likidim ne thesarin e shtetit, gjithashtu Akti i Kolaudimit te kontrates baze i paraqitur, i certifikon pozitivisht punimet ne respektim te plote me standartet e KTZ, te afateve dhe kontrates se nenshkruar, e paraqitem si pune te ngjashme. Pavaresisht se kriteri i puneve te ngjashme te vendosur me AK plotesohet vetem me objektin “Ndertimi i HEC-it Borje Oreshke” ne si shoqeri e paraqitem objektin “Furnizimi me uje i fshatrave te komunes Golem” (ku teknikisht eshte i plote) per te garantuar edhe me shume AK se pervoja jone ne keto pune te ngjashme eshte ne nivelet me te larta.”[...]

II.4.1.Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 1090 Prot. datë 28.09.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën operatorit ekonomik ankimues “GPG Company” sh.p.k., duke e refuzuar atë me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]Ne lidhje me pretendimin tuaj se firmat e tjera te kualifikuara nuk permbushin piken ku kerkohet te permbushet kriteri i paraqitja se punimeve te ngjashme, u bene verifikimet e duhura dhe pretendimi juaj ne lidhje me kete pike nuk qendron. Ne lidhje me piken tjeter ku ju pretendoni se nuk eshte permbushur nga firmat e kualifikuara te tjera ju sqarojme si me poshte: Pretendimi Juaj konsiston ne mos plotesimin e pikes 8 te 2.3 kapacitetit teknik ku kerkohet qe: operatori/loperoret ekonomik ofertues te vertetojne se disponon/disponojne kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per ktyerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt. Per kete aperiatori/operoret ekonomik duhet te paraqese/paraqesin dokumentacion qe verteton se Operatori/aperoret ekonomik duhet te kete/kene si staf teknik te cilet te figurojne te rregjistruar ne listpagesa...

keta punonjes te operatoreve te mundeshem ofertues vertetohen me: për secilin punonjës me diplomë, kontratë pune dhe CV. Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se punonjesit e kerkuar ne piken 2.3.5 per kualifikim jane te pa angazhuar me kontrata te tjera. Sa me lart pas

verifikimeve te bera u konstatua se te gjithë operatorët e kualifikuar kane paraqitur per kete staf drejtues diplomat perkatese kontraten e punes perkatese si dhe CV te e tyre po ashtu ata kane deklaruar se nuk jane te angazhuar ne kontrata te tjera. Sa me siper detyrimi I operateve ekonomik eshte te kene keta drejtues ne listepagesa, me kontrata te regullta dhe me diplome dhe CV perkatese. Nese keta punonjes jane te perfshire ne punesime te tjera por ne te njejten kohe firmosin kontrata punesimi me Operatoret ekonomike kjo eshte ne pergjegjesine e tyre dhe cdo shkelje ligjore ne kete aspekt prap eshte pergjegjesia e tyre ligjore. Operatoret ekonomike kane deklaruar se keta punonjes nuk jane te angazhuar ne punesime te tjera dhe nese ata jane ne dijeni te kesaj por kane bere deklarate te reme kjo eshte pergjegjesi ligjore e tyre. Nderkohe KVO nga ana e saj kerkon qe operateret ekonomik te plotesojne te gjitha kriteret e kualifikimit te percaktuara ne DST dhe sa me lart eshte verifikuar se operateret ekonomike kane paraqitur te gjitha dokumentat e kerkuam per te verifikuar kerkesat e DST ve. Sa me siper eshte shpjeguar pretendimi juaj edhe ne kete pike nuk qendron. Ne lidhje me pretendimin tuaj se ju vete si operatr ekonomik plotesoni kriterin e kontratave te ngjashme sqarojme se ju jeni kualifikuar dhe jeni renditur si operator qe ka plotesuar kriteret me shumecë votash pra pretendimi juaj nuk shqyrtohet pasi ju po kerkoni nje te drejte qe ju eshte dhene tashme.[...]

II.4.2.Në datën 08.10.2018 operatori ekonomik ankimues “GPG Company” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Pikë së pari në këtë klasifikim , nuk janë respektuar parimet dhe rregullat e prokurimit publik, pasi edhe pse të kualifikuar, të gjithë operatorët ekonomik kishin edhe arsye skualifikimi bashkangjitur. (Bashkangjitur vlersimi). Pikë së dyti, arsyet e skualifikimit për operatorët ekonomik të kualifikuar ishin mosparaqitja e kontratave të ngjashme të së njëjtës natyrë më objektin që prokurohet. Pas shqyrtimit vleresimit të ofertave per kete procedure, shoqeria “GPG Company” shpk ka paraqitur ankësën mbi klasifikimin e ofertave pranë autoritetit kontraktor Sh.A Ujësjiellës Tepelenë me Nr. 1083 Prot, datë 26.09.2018 brënda afateve ligjore që parashikon neni 63 pika 1.1 e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dorëzuar.

-operatorët pjesmarrës të kualifikuar të parët nuk plotësojnë kriterin e vendosur nga Autoriteti Kontraktor , punë e ngjashme,

-se në stafin teknik të tyre përfshihen punonjës që rezultojnë të emëruar në Administratën Publike, cka bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

-Se shoqëria jonë e plotëson kriterin për punë të ngjashme disa herë më të mëdha se se kriteri i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, konkretish “Ndërtimi i HEC-it Borje Oreshke Kukës” dhe “Furnizimi me ujë i fshatrave të komunës Golem”

Autoriteti Kontraktor, Sh.a Ujësjiellës Tepelenë ka kthyer përgjigje me shkresën me Nr.1090 Prot, datë 28/09/2018, duke e rrëzuar ankesën tonë, pa i shqyrtuar të pretendimet tona. Ndër të tjera Autoriteti Kontraktor citon: “...gjithashtu ju ankimoni edhe vlersimin si të papërbushur te kriterit të punës se ngjashme” të së njëjtës natyre , pasi operatori ekonomik nuk ka formularë vlersimi, dhe akt kolaudimi përfundimtarë për objektin :Furnizimi me ujë i fshatrave të komunës Golem” dhënë nga njëri prej antarëve të KVO-së.. ”

Për sa më sipër Shoqëria “GPG Company” shpk sqaron se: Në përgjigje të ankesës sonë nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është dhënë asnjë informacion mbi arsyetimin e skualifikimit për punë të ngjashme me kontratën e paraqitur nga ana jonë me objekt “Ndërtimi i HEC-it Borje Oreshke Kukës” me një vlerë 858,454,617 (tetqind e pesëdhjetë e tetë milion e katërqind e pesëdhjetë e katër

mijë e gjashtëqind shtatëmbëdhjetë”, e cila përmbush të gjithë kriterin e kërkuar nga ky Autoritet Kontraktor për punë të ngjashme. Gjithashtu në ankesën e paraqitur nga shoqëria jonë u sqarua edhe kontrata e ngjashme e lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Agjencia Kombëtare Ujësjiellës Kanalizimeve , me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të komunës Golem”. Përkatësisht në aktesën tonë drejtuar Autoriteti Kontraktor SHA Ujësjiellës Tepeplenë, ju sqarua se kjo kontratë ka përfunduar punimet e saj në masën 100 %. Për të vërtetuar këtë shoqëria jonë ka paraqitur të gjithë dokumentat e nevojshëm që vërtetojnë realizimin me sukses të kësaj kontrate, si kontratën e lidhur midis shoqërisë tonë dhe autoriteti Kontraktor, Aktin e kolaudimit dhe situacionin përfundimtarë dhe faturën e likuidimit total të kontratës bazë. Përsa i përket pretendimit të Autoriteti Kontraktor Sh.a Ujësjiellës Tepelenë së shoqëria jonë nuk ka paraqitur Formularë Vlersimi dhe Akt Kolaudimin ju bëjmë me dije se: Mbikqyrsi i punimeve ka bërë kërkesë pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës Kanalizimeve për shtesë kontrate, për shkak të punimeve shtesë të dala në procesin e realizimit. Si e tillë pas përfundimit të shtesës atëherë shoqëria do të pajiset me Formularin e Vlersimit dhe Aktin e Kolaudimit. Sa më sipër cituar duket qartazi që Shoqëria “GPG Company” shpk e përmbush plotësisht këtë kriter edhe vetëm më njëherë pre kontratave të ngjashme të paraqitura. Autoriteti Kontraktor SHA Ujësjiellës Tepelenë, në përgjigjen e ankesës tonë vijon: “në lidhje me pretendimin tuaj se firmat e tjera të kualifikuara nuk përmbushin pikën ku kërkohet të përmbushin kriterin e paraqitjes së punimeve të ngjashme, u bënë verifikimet e duhura dhe pretendimi juaj në lidhje me këtë pikë nuk qëndron” Për sa më sipër Shoqëria jonë konstaton se, Në dokumentat standarte të tenderit të ngarkuara nga Autoriteti Kontraktor, ndër të tjera kërkohet se : ”Kapaciteti teknik: a. Punë të ngjashme për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë në një vlerë prej 50% te fondit limit, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, OSE” Operatorët ekonomikë, pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi, janë kualifikuar nga Autoriteti Kontraktor, duke paraqitur kontrata të ngjashme që nuk kanë aspak lidhje me natyrën objektin që prokurohet, cka bië në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”. Gjithashtu shoqëritë që kanë qënë pjesmarrës në këtë procedurë si Bashkim Operatorësh Ekonomik, nuk plotësojnë as vlerën e punimeve të përcaktuara në bazë të përqindjes të ndarë në marrëveshjen e bashkpunimit. Përsa i përket pretendimit të dytë të shoqërisë “GPG Company” shpk , mbi stafm e drejtuesve teknik të paraqitur nga operatorët e tjerë pjesmarrës, që rezultojnë të punësuar në Institucionet e Administratës Shtetërore, Autoriteti Kontraktor, SH.A Ujësjiellës Tepelene , argumenton se: “ Operatorët ekonomik pjesmarrës kanë bërë deklarata se stafi teknik do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt dhe se nuk janë te angazhuara në punësime të tjera. është përgjegjësi e oparatorëve ekonomik që bëjnë deklaratë të rreme” Për sa më sipër shoqëria jonë disponon të dhëna të sakta që punonjësit e deklaruar në stafin teknik , operatorëve ekonomik, janë të punësuar në Administratën Publike. Në momentin që ne një procedurë prokurimi, njëri nga Operatorët ekonomik bën Ankesë për deklarata të rreme të Operatorëve Ekonomik, është totalisht e jashtëligjshme që Autoriteti Kontraktor te kualifikojë këto operatorë me pretendimin se është përgjegjësi e tyre për deklaratat e rreme. Në të tilla raste kur, Autoriteti Kontraktor i vihet në dispozicion një informacion i tillë, ai kurrsesi nuk duhet të anashkalojë, por të dërgojë kërkesë për informacion tek Institucionet të cilat rezultojnë këta të punësuar. Përsa i përket këtij pretendimi shoqëria jonë ju bën me dije se: 1.Drejtuësi Teknik Znj. L. M. i shoqërisë ALB SHPRESA është njëkohësisht i punësuar në shtët, konkretisht ZYRA QEND RREGJISTRIMI TË PASURIVE” 2.Drejtuësi Teknik Z. A. K. i shoqërisë ALB SHPRESA është njëkohësisht i punësuar në shtët , konkretisht GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË” 3.Drejtuësi Teknik Z. Z. G. i shoqërisë ALB SHPRESA është njëkohësisht i punësuar në shtët, konkretisht ZYRA QEND RREGJISTRIMI TË PASURIVE të paluajtshme”[...]

II.5.Në datën 19.10.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1143prot., datë 18.10.2018 ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6.Në datën 15.10.2018, me anë të shkresës nr.134prot, datë 26.09.2018, operatori ekonomik “Biba-X” sh.p.k., ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik se ka vendosur të tërhiqet në mënyrë të përvokueshme nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesave të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “G.P.G Company” sh.p.k, mbi arsyen e skualifikimit të ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...] -Se shoqëria jonë e plotëson kriterin për punë të ngjashme disa herë më të mëdha se se kriteri i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, konkretisht “Ndërtimi i HEC-it Borje Oreshke Kukës” dhe “Furnizimi me ujë i fshatrave të komunës Golem” [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nëpërmjet informacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor, pretendimet e ankimuesit, si dhe nga verifikimet e bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik, konstatohet se arsyeja e skualifikimit e cila kundërshtohet nga ankimuesi, është mendimi i një prej tre anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, ndërkohë që dy prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave nuk kanë ngritur arsye skualifikimi për operatorin ekonomik ankimues, duke vendosur me shumicë votash kualifikimin e ofertës së tij si rrjedhojë e plotësimit të kriterëve të përgjithshme dhe të vecanta të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

III.1.2. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.1.3. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, duhet të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimues rezulton i kualifikuar në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi. Arsyeja e skualifikimit e ngritur nga një prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, është mendim pakice dhe nuk ka sjellë pasojë që mund të dëmtonin interesat e ankimuesit. Në këto kushte, përsa kohë operatori ekonomik ankimues nuk është dëmtuar nga kjo arsye skualifikimi, këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

III.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "G.PG Company" sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të BOE "Eral Construction Company" sh.p.k., & "Sterkaj" sh.p.k. & "Alb Shpresa" sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin : *"Operatorët ekonomikë, pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi, janë kualifikuar nga Autoriteti Kontraktor, duke paraqitur kontrata të ngjashme që nuk kanë aspak lidhje me natyrën objektin që prokurohet, cka bië në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, pika 2.3 "Kapaciteti Teknik". Gjithashtu shoqëritë që kanë qënë pjesmarrës në këtë procedurë si Bashkim Operatorësh Ekonomik, nuk plotësojnë as vlerën e punimeve të përcaktuara në bazë të përqindjes të ndarë në marrëveshjen e bashkpunimit", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1.Në pikën 2.3.1 të shtojcës 12, "Kapaciteti teknik", në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ndryhsuar me shtojcën 1 *"Për modifikimin e dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit "Procedure e hapur" me objekt "Ndertimi i linjave të shperndarjes së qytetit Tepelene", autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:*

*"a. Punë të ngjashme për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë në një vlerë prej 50% të fondit limit, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, ose
b.punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se 184 527 766 lekë.*

(do të pranohen punime të realizuara me sukses gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe jo të aktivitetit të OE.)

Si dëshmi për të vlerësuar përvijën e mëparshme ofertuesi duhet të paraqesë këto dokumenta:

- FORMULAR VLERESIMI

- Kontratën/kontratata me entet publike, për përbushjen e suksesshme të punëve ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë.

- Aktin/aktet e kolaudimit të objektit/objekteve.

- Situacionin përfundimtar.

-Faturat Tatimore

- per subjektet private, faturat tatimore te deklarimit te objektit ne organet tatimore, lejes se ndertimit perkatese,Aktin/aktet e kolaudimit leja e perdorimit,situacionin përfundimtar."

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Eral Construction Company" sh.p.k., & "Sterkaj" sh.p.k. & "Alb Shpresa" sh.p.k., rezulton se, është paraqitur dokumenti Kontratë Bashkëpunimi nr.743rep., nr.303kol., datë 10.09.2018, ndërmjet shoqërive "Eral Construction Company" sh.p.k., "Sterkaj" sh.p.k. dhe "Alb Shpresa" sh.p.k., nga ku shoqëria "Eral Construction Company" sh.p.k. merr përsipër të realizojë 23.4% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi, shoqëria "Sterkaj" sh.p.k. ka marrë përsipër të realizojë 64.6% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi, ndërsa shoqëria "Alb Shpresa" sh.p.k. ka marrë përsipër të realizojë 12% të vlerës së preventivit të ofertuar.

III.2.3.Nga verifikimi i kryer nga KPP, për plotësimin e kriterit të mësipërm, bashkimi i operatorëve ekonomikë "Eral Construction Company" sh.p.k., & "Sterkaj" sh.p.k. & "Alb Shpresa" sh.p.k. ndër të tjera, ka paraqitur:

- Kontratë nr.21prot. datë 23.12.2015, lidhur ndërmjet Bashkisë Sarandë dhe bashkimit të shoqërive “Sterkaj” sh.p.k. & “Riviera” sh.p.k., me objekt “Zëvendësimi i tubacionit të ujësjellësit nga stacioni i pompimit Vrion deri në rezervuarin e qytetit”, shoqëruar me akt kolaudimi, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, fatura tatimore shitje ”
- Kontratë nr.1868/14prot. datë 15.12.2015, lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe operatorit ekonomik “Eral Construction Company” sh.p.k., me objekt “Rikonstruksion I rrugës “Hamdi Cenojmeri” (faza e II-të)”, shoqëruar me akt kolaudimi, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, fatura tatimore shitje.
- Kontratë Ref.P/Punë/2017/GOA/P77 datë 17.05.2017, lidhur ndërmjet Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkimit të shoqërive “Mela” sh.p.k. & “Alb Shpresa” sh.p.k., me objekt “Rikonstruksioni i rrugës “Gërmenj-Okshtun-Zambishte””, shoqëruar me akt kolaudimi, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, fatura tatimore shitje.

III.2.4.Neni 26, pika 6 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon:

“6.Për të provuar përvojën mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: a)punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. b)punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohenvlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshmetë punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohenvlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshmetëpunëve.

III.2.5.Neni 74 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon:

“1.Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

2.Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen nëbashkimin eoperatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

3.Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare,

profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

3.Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.”

III.2.6. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik në përmbushje të kriterit të vecantë të kualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, operatori ekonomik “Sterkaj” sh.p.k. ka paraqitur kontratë nr.21prot. datë 23.12.2015, lidhur ndërmjet Bashkisë Sarandë dhe bashkimit të shoqërive “Sterkaj” sh.p.k. & “Riviera” sh.p.k., me objekt “Zëvendësimi i tubacionit të ujësjellësit nga stacioni i pompimit Vrion deri në rezervuarin e qytetit”, shoqëruar me akt kolaudimi, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, fatura tatimore shitje, për të cilën kanë përfunduar me sukses punimet, në datën 23.12.2016 (brenda 3 viteve të fundit) në vlerën totale 126,023,592 lekë me TVSH ose 105,019,660 lekë pa TVSH dhe e ndarë sipas përqindjes të punimeve të kryera “Sterkaj” sh.p.k. 73% = 91,997,222.16 lekë me TVSH ose 76,664,351.8 lekë pa TVSH dhe “Riviera” sh.p.k. 27% = 34,026,369.84 lekë me TVSH ose 28,355,308.2 lekë pa TVSH. Operatori ekonomik “Eral Construction Company” sh.p.k., ndër të tjera ka paraqitur kontratë nr.1868/14prot. datë 15.12.2015, lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe operatorit ekonomik “Eral Construction Company” sh.p.k., me objekt “Rikonstruksion I rrugës “Hamdi Cenojmeri” (faza e II-të)”, shoqëruar me akt kolaudimi, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, fatura tatimore shitje, për të cilën ka përfunduar me sukses punimet, në datën 15.06.2016 (brenda 3 viteve të fundit) në vlerën totale 20,197,932 lekë me TVSH ose 16,831,610 lekë pa TVSH. Ndërsa operatori ekonomik “Alb Shpresa” sh.p.k. ka paraqitur Kontratë Ref.P/Punë/2017/GOA/P77 datë 17.05.2017, lidhur ndërmjet Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkimit të shoqërive “Mela” sh.p.k. & “Alb Shpresa” sh.p.k., me objekt “Rikonstruksioni i rrugës “Gërmenj-Okshtun-Zambishte””, shoqëruar me akt kolaudimi, situacion përfundimtar, formular vlerësimi, fatura tatimore shitje, për të cilën kanë përfunduar me sukses punimet, në datën 27.02.2018 (brenda 3 viteve të fundit) në vlerën totale 82,799,701 lekë me TVSH ose 68,999,750.83 lekë pa TVSH dhe e ndarë sipas përqindjes të punimeve të kryera “Mela” sh.p.k. 45% = 37,259,865.45 lekë me TVSH ose 31,049,887.87 lekë pa TVSH dhe “Alb Shpresa” sh.p.k. 55% = 45,539,835.55 lekë me TVSH ose 37,949,862.96 lekë pa TVSH. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, me dokumentacionin e paraqitur, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eral Construction Company” sh.p.k., & “Sterkaj” sh.p.k. & “Alb Shpresa” sh.p.k. vërteton se plotëson kërkesat për kualifikim për përvojë të suksesshme, pasi kontratat e paraqitura, janë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit sipas zërave të marra përsipër në kontratën e

bashkëpunimit, gjithashtu vlera e kontratave dhe faturave tatimore të paraqitura nga të tre anëtarët e bashkimit të përkohshëm të operatorëve, jo vetëm përmbushin vlerën e kërkuar të përcaktuar shprehimisht nga ana e autoritetit kontraktor por edhe e tejkalojnë atë, pasi shoqëria “Sterkaj” sh.p.k. si pjesëtarja me përqindjen më të madhe në bashkim, e cila ka marrë përsipër të kryej të gjitha punimet me karakter hidraulik të ujësjellësit, me kontratën e sipërcituar, plotëson e vetme vlerën prej 50% të fondit limit në përputhje me pikën 3 të nenit 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Gjithashtu kjo kontratë e paraqitur është plotësisht e ngjashme me objektin e prokurimit, pasi kemi të bëjmë me punime ndërtimore të ujësjellsave, ndërsa shoqëria “Eral Construction Company” sh.p.k. dhe shoqëria “Alb Shpresa” sh.p.k., plotësojnë secila vlerat përkatëse sipas përqindjeve të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit. Gjithashtu, kontratat e paraqitura e plotësojnë kushtin për tu konsideruar të ngjashme, pasi në kontratën e bashkëpunimit, këto dy shoqëri kanë marrë përsipër të kryejnë punime ndërtimore si gërmim dheu; transport dheu; prishje betoni; shtresa cakullli; shtresa stabilizanti; shtresa binderi etj, punime të cilat i kanë kryer në zbatim të kontratave të paraqitura. Komisioni sqaron se në asnjë rast nuk mund të pretendohen zëra të njëjtë për të gjithë zërat e preventivit, pasi një gjë e tillë të çon drejt përcaktimit të zërave të njëjtë të punimeve në kundërshtim kjo me rregullat e prokurimit publik si më sipërcituar. Një përcaktim i tillë që në vetvete nënkupton eksperiencën të njëjta apo zëra të njëjtë të shërbimeve/punëve publike apo mallrave, bie në kundërshtim edhe me vetë frymën dhe qëllimin e ligjit të përcaktuara në nenin 1 të tij, duke frenuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të këtyre operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Referuar aktit nënligjor në fuqi mbi rregullat e prokurimit publik, përcakton se operatorët ekonomik, pjesëtarë të një bashkimi të përkohshëm, kanë detyrimin të vërtetojnë se plotësojnë kushtin e eksperiencës të ngjashme me ato zëra punimesh të preventivit që kanë përsipër të kryejnë sipas kontratës së bashkëpunimit. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Në këto kushte, Komisioni gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eral Construction Company” sh.p.k., & “Sterkaj” sh.p.k. & “Alb Shpresa” sh.p.k. e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.1 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ndryshuar me shtojcën 1 “Për modifikimin e dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur” me objekt “Ndërtimi i linjave të shpërndarjes së qytetit Tepelene”.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “G.P.G Company” nuk qëndron.

III.3.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ”G.PG Company” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të BOE “Eral Construction Company” sh.p.k., & “Sterkaj” sh.p.k. & “Alb Shpresa” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin : “[...]shoqëria jonë disponon të dhëna të sakta që punonjësit e deklaruar në stafin teknik , operatorëve ekonomik, janë të punësuar në Administratën Publike. Në momentin që ne një procedurë prokurimi, njëri nga Operatorët ekonomik bën Ankesë për deklarata të rreme të Operatorëve Ekonomik, është totalisht e jashtëligjshme që Autoriteti Kontraktor të kualifikojë këto operatorë me pretendimin se është përgjegjësi e tyre për deklaratat e rreme. Në të tilla raste kur, Autoriteti Kontraktor i vihet në dispozicion një informacion

i tillë, ai kurrësi nuk duhet të anashkalojë, por të dërgojë kërkesë për informacion tek Institucionet të cilat rezultojnë këta të punësuar. Përsa i përket këtij pretendimi shoqëria jonë ju bën me dije se: 1.Drejtuesi Teknik Znj. L. M. i shoqërisë ALB SHPRESA është njëkohësisht i punësuar në shtët, konkretisht ZYRA QEND RREGJISTRIMI TË PASURIVE” 2.Drejtuesi Teknik Z. A. K. i shoqërisë ALB SHPRESA është njëkohësisht i punësuar në shtët , konkretisht GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË” 3.Drejtuesi Teknik Z. Z. G. i shoqërisë ALB SHPRESA është njëkohësisht i punësuar në shtët, konkretisht ZYRA QEND RREGJISTRIMI TË PASURIVE të paluajtshme”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1.Në pikën 2.3.7 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ndryshuar me shtojcën 1 “Për modifikimin e dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit“Procedure e hapur” me objekt “Ndertimi i linjave të shperndarjes se qytetit Tepelene”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“8.Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt. Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacion qe verteton se Operatori ekonomik duhet te kete si staf teknik te cilet te figurojne te rregjistruar ne listpagesa si dhe ne licencen e shoqerise Inxhinierat e meposhtem:

- 2 (dy) inxhinier ndërtimi
- 1 (një) inxhinier transporti
- 2 (dy) inxhinier hidroteknik
- 2 (dy) inxhinier gjeodet
- 1 (një) inxhinier elektrik
- 1 (nje) inxhinier mekanik
- 1 (nje) inxhinier mjedisi

Të shoqëruara për secilin punonjës me diplomë, kontratë pune dhe CV. Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se punonjesit e kerkuar ne piken 2.3.5 per kualifikim jane te pa angazhuar ne kontrata te tjera.”

III.3.2.Nga verifikimet e kryera në SPE, rezulton se, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, operatori ekonomik “Alb Shpresa” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Licencë Profesionale e Shoqërisë
- Deklaratë mbi caktimin e drejtuesit teknik.
- Kontratë Pune, CV, Librezë Pune, Diplomë, për Drejtuesin Teknik E. L., Ing. Ndërtimi.
- Kontratë Pune, CV, Librezë Pune, Diplomë, për Drejtuesin Teknik L. M., Ing. Mjedisi.
- Kontratë Pune, CV, Librezë Pune, Diplomë, për Drejtuesin Teknik Gj. L., Ing. Elektrik.
- Kontratë Pune, CV, Librezë Pune, Diplomë, për Drejtuesin Teknik A. K., Ing. Hidroteknik.
- Kontratë Pune, CV, Librezë Pune, Diplomë, për Drejtuesin Teknik V. N., Ing. Mekanik.
- Kontratë Pune, CV, Librezë Pune, Diplomë, certifikatë profesionale për Drejtuesin Teknik Z. G., Ing. Markshajder.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat

e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.3.4. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, përcaktohet se: “8.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:a)licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose; b)dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose; c)dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushurkontratën.”

III.3.5.Referuar dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik “Alb Shpresa” sh.p.k. ka paraqitur Licencën profesionale të shoqërisë, si dhe kontratat e punës të stafit inxhinierik të saj, shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Lidhur me pretendimin e ankimesit se inxhinierët L.M., A.K. dhe Z.G janë të punësuar në administratën shtetërore, Komisioni konstaton se, inxhinierët e sipërcituar janë inxhinier hidroteknik (A.K.); inxhinier mjedisi (L.M.) dhe inxhinier markshajder (Z.G.). Nga ana tjetër, konstatohet se operatori ekonomik “Alb Shpresa” sh.p.k., ka paraqitur deklaratën mbi caktimin e drejtuesit teknik për zbatimin e kontratës objekt prokurimi, në të cilën deklaron se drejtues teknik i kësaj shoqërie do të jetë vetëm inxhinieri i ndërtimit M.L., ndërsa inxhinierët për të cilët ngrihen pretendime, nuk i ka deklaruar si drejtues teknik për zbatimin e kontratës objekt prokurimi. Referuar kontratës së bashkëpunimit të shoqërive, operatori ekonomik “Alb Shpresa” sh.p.k., ka marrë përsipër të kryej 12 % të zërave të preventivit të punimeve, përkatësisht gërmim dheu; transport dheu; prishje betoni; shtresa cakulli, stabilizanti dhe binderi. Në këto kushte, bazuar në zërat e preventivit të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit, si dhe bazuar në faktin që drejtues teknik i shoqërisë është deklaruar vetëm inxhinieri i ndërtimit M.L., Komisioni gjykon se statusi (të dypunësuar apo jo) i inxhinierëve për të cilët ngrihen pretendime nga ankimesi, nuk ndikon aspak për zbatimin e punimeve të marra përsipër nga operatori ekonomik “Alb Shpresa” sh.p.k., përsa kohë nuk janë të deklaruar si drejtues teknik për zbatimin e ndonjë prej detyrave në zbatim të kontratës objekt prokurimi. Edhe në hipotezën se këta inxhinierë do të ishin të papajtueshëm me pozicionin e drejtuesit teknik, në përputhje me nenin 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, drejtuesit teknik, Inxhinier Mjedis, Hidroteknik dhe Markshajder /Gjeodet/ Topograf, janë paraqitur nga dy shoqëritë e tjera pjesëmarrëse në bashkim, të cilët kanë patur edhe barrën për të vërtetuar disponimin e tyre referuar zërave të preventivit të punimeve të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Gjithashtu, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në

përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “G.P.G Company” sh.p.k., nuk qëndron.

III.4.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “G.P.G Company” sh.p.k. ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Shansi Invest” sh.p.k., & “Lala” sh.p.k. & “Biba X” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shyrtime, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi BOE “Eral Construction Company” sh.p.k., & “Sterkaj” sh.p.k. & “Alb Shpresa” sh.p.k. përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e BOE “Shansi Invest” sh.p.k., & “Lala” sh.p.k. & “Biba X” sh.p.k., nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “G.P.G Company” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt, “Procedurë e hapur”, me objekt “Ndërtimi i linjave të shpërndarjes të qytetit Tepelenë”, me nr. REF-81992-08-03-2018, me fond limit 92,263,883 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 11.09.2018, nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tepelenë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1569 protokoli Datë 08.10.2018;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha